

10 shtator 2026

Të nderuara familje:

Mirë se u rikthyet! Jam shumë i emocionuar që po e fillojmë së bashku vitin shkollor 2026–27.

Dita e parë e shkollës është një nga periudhat e mia të preferuara të vitit; ajo sjell kaq shumë mundësi dhe fillime të reja. Qoftë nëse fëmija juaj është një nxënës i kopshtit që hyn për herë të parë në klasë duke mbajtur me krenari çantën e tij të madhe të shpinës, një nxënës i shkollës së mesme të ulët që provon kombinimin e ri të dollapit të tij, apo një maturant që bën me miqtë fotografitë e fundit të ditës së parë të shkollës, shpresoj që familja juaj të ndiejë të njëjtën ndjesi shprese dhe mundësish.

Gjatë viteve, kam përjetuar shumë ditë të para shkolle si mësues dhe si prind. Në secilin prej këtyre roleve, kam mësuar nga përvoja e drejtpërdrejtë se sa shumë besim u japin familjet tona çdo ditë Shkollave Publike të Qytetit të Nju-Jorkut. Të gjithë ndajmë të njëjtat shpresa për fëmijët tanë: që ata të hyjnë në shkollë duke u ndier të mirëpritur, të mbështetur dhe të gatshëm për të mësuar. Në “ditën time të parë” si kancelar, angazhimi im është që kjo përvojë të bëhet realitet për çdo fëmijë në çdo shkollë.

Që kur mora këtë detyrë, kam pasur privilegjin të dëgjoj qindra nxënës, familje, edukatorë dhe anëtarë të komunitetit në të pesë njësitë administrative të qytetit. Bisedat e mia me të gjithë ju kanë ndihmuar në përcaktimin e prioriteteve të mia për vitin e ardhshëm: të krijojmë shkolla të sigurta, me standarde të larta akademike dhe vërtet të integruara. Me fjalë të tjera, duam të sigurohemi që çdo nxënës të ndiejë se i përket komunitetit të shkollës dhe të ketë mbështetjen që i nevojitet për të arritur potencialin e tij të plotë në një mjedis të fuqishëm mësimor që merr parasysh dhe respekton kulturat e ndryshme.

Ndërsa fillojmë vitin e ri shkollor, ju lutemi, dijeni se jemi këtu për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja dhe për t'ju ofruar çdo mbështetje që mund t'ju nevojitet. Koordinator i prindërve, drejtori, mësuesit dhe stafi i shkollës suaj janë këtu për t'ju ndihmuar në çdo hap. Shkollat tona i mirëpresin të gjithë nxënësit dhe duam që çdo familje ta dijë se këtu ka vend për të dhe se është pjesë e komunitetit tonë.

Ju uroj juve dhe familjes suaj një vit të mrekullueshëm plot mësim dhe zhvillim. Mezi pres të vazhdoj komunikimin me të gjithë ju dhe pres me kënaqësi gjithçka që do të arrijmë së bashku gjatë këtij viti shkollor.

Në bashkëpunim,



Kamarr H. Samuels
Kancelar (Chancellor)